

✦ Njesia e Sigurimit Teknik

- ❑ Njësia e Sigurimit Teknik fokusohet në garantimin e sigurisë teknike në hapësirën e Autoritetit Portual Durrës ku në mënyrë eksplicite Auditon Standardet e Sigurisë në punë nga subjektet publike dhe jo publike si dhe kontrollon dhe asiston praktikën formale dokumentare të këtyre subjekteve.
- ❑ Njësia kryen auditimin e standardeve të sigurisë në punë nëpërmjet metodës së inspektimit në terren, vëzhgimit të operacioneve të anijeve të akostuara në kalatë, të procesit të ngarkim – shkarkimit, operacioneve në sheshe, magazinimit, tranzitimit apo aktiviteteve të tjera të kryera në hapësirën e Autoritetit Portual Durrës.
- ❑ Njësia evidenton inspektimet në terren nëpërmjet formularit “ akt – konstatimi” të mbajtur në dy kopje ku njëra i behet prezent dhe i vihet në dispozicion subjektit të audituar.
- ❑ Njësia asiston në ekspertizën e aksidenteve ose incidenteve ku evidenton, bën analizën shkakësore, nxjerr konkluzionet, përgjegjësit, rekomandimet specifike diktuar nga precedenti dhe për sa e diktojnë kompetencat propozon sanksionet administrative sipas referencave përkatëse.
- ❑ Njësia evidenton zonat dhe sektorët me rrisht për jetën, shëndetin, për dëmtimet materiale dhe bazuar në analizën shkakësore sugjeron marrjen e masave.
- ❑ Njësia gjatë auditimit kryen fotografimin, verifikimin për matrikullimet në mallrat e rrezikshme, matjet për tonazhet e papërcaktuara dhe testet për mosdisponim të certifikimeve përkatëse.
- ❑ Njësia përmbush detyrimet ligjore të auditimit lidhur me standardet dhe parametrat e sigurisë teknike për mjetet, mekanizmat, makineritë teknologjike, pajisjet, linjat, impiantet, për sigurinë e pajisjeve dhe veglave të takillazhit, aksesoreve, pajisjeve personale mbrojtëse (PPM).

✦ Njesia e Sigurimit Teknik

- ❑ Njësia bashkërendon punën me “Këshillin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë” të APD-së për konfigurimin e detyrave dhe objektivave të planit vjetor për kontrollin, identifikimin dhe parandalimin e rreziqeve të mundshëm për dëmtimin e shëndetit dhe jetës .
- ❑ Njësia evidenton zonat dhe sektorët me rrisik për jetën, shëndetin, për dëmtimet materiale dhe bazuar në analizën shkakësore sugjeron marrjen e masave.
- ❑ Njësia asiston në ekspertizën e aksidenteve, incidenteve, evidenton, bën analizën shkakësore, nxjerr konkluzionet, përgjegjësit dhe mban regjistrin e aksidenteve.
- ❑ Njësia në bashkërendim me nevojën e subjekteve punëdhënëse publike dhe jo publike, menaxherëve të sigurisë në stafet e tyre këshillon, instrukton, udhëzon mbi standardet e sigurisë në punë me synim minimizimin e risqeve në hapësirën e Autoritetit Portual Durrës.
- ❑ Njësia asiston në azhurnimin e vazhdueshëm të stafeve të sigurisë teknike të subjekteve që operojnë në APD, në varësi të ndryshimeve të legjislacionit përkatës.
- ❑ Njësia përpilon informacionin periodik vjetor lidhur me zbatimin e standardeve të sigurimit teknik dhe shëndetit në punë të subjekteve publike dhe jopublike që operojnë në Autoritetin Portual Durrës për Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Promocionit.